UDHËZIM
Nr. 16, datë 17.4.2025

PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË SHKËMBIMIT TË STUDIMEVE UNIVERSITARE NË EVROPËN QENDRORE "CEEPUS IV" NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 19/2024, "Për ratifikimin e marrëveshjes në lidhje me programin e shkëmbimit të studimeve universitare në Evropën Qendrore 'CEEPUS IV'"; dhe urdhrit nr. 113, datë 26.3.2024, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Ana Kapaj", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Programi "CEEPUS IV" mbështet bashkëpunimin ndëruniversitar në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, shkëmbimin e studentëve, të stafit akademik dhe kërkuesve shkencorë ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë pjesëmarrëse të vendeve anëtare në këtë program.

2. Bursat e studimit të CEEPUS IV janë grante gjithëpërfshirëse që do të mbulojnë kostot e jetesës, shpenzimet për tarifat laboratorike sipas praktikës së përgjithshme në vendin pritës, në rastet e zbatueshme, si edhe akomodimin dhe sigurimin bazë shëndetësor, në rastet e zbatueshme, gjatë qëndrimit në vendin pritës. Bursat e studimit të CEEPUS IV do të jenë në raport me kostot e jetesës në vendin pritës përkatës dhe inflacionin e tij.

3. Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), në përputhje me ligjin nr. 19/2024, "Për ratifikimin e Marrëveshjes në lidhje me programin e shkëmbimit të studimeve universitare në Evropën Qendrore 'CEEPUS IV'", dhe në bazë të fondeve buxhetore në dispozicion, i njofton/i garanton Komitetit të Përbashkët të Ministrave CEEPUS kuotat e saj për çdo vit të ardhshëm akademik. MAS-i i transferon Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) fondet përkatëse për programin "CEEPUS IV", në përputhje me kuotat e parashikuara, për të cilat është njoftuar Komiteti i Përbashkët i Ministrave CEEPUS.

4. Bazuar në pikën 3, të nenit 4, të ligjit nr. 19/2024, "Për ratifikimin e marrëveshjes në lidhje me programin e shkëmbimit të studimeve universitare në Evropën Qendrore 'CEEPUS IV'", Ministria e Arsimit dhe Sportit ngarkon Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) me zbatimin e programit CEEPUS IV në Shqipëri, e cila do të luajë rolin e Zyrës Kombëtare CEEPUS (ZKC) dhe ka përgjegjësitë e mëposhtme:

a) të organizojë zbatimin e programit të CEEPUS IV, sipas rregulloreve përkatëse kombëtare dhe juridiksioneve financiare;

b) të promovojë dhe të informojë rreth programit, si dhe të shpërndajë rezultatin e bashkëpunimit në nivel kombëtar;

c) të këshillojë kërkuesit e mundshëm, në lidhje me bashkëpunimin e rrjetit dhe programin e bursave të studimit;

d) të marrë dhe të vlerësojë zyrtarisht aplikimet, si dhe të organizojë vlerësimin e rrjetit të ekspertëve në nivel kombëtar;

e) të japë dhe të përpunojë bursat e studimit në bazë të programit përkatës të punës dhe të rregulloreve kombëtare;

f) të organizojë pagesat, në lidhje me bursat e studimit që korrespondojnë me rregulloret kombëtare, si dhe në përputhje me juridiksionet përkatëse financiare të palës kontraktuese;

g) të veprojë si një këshilltar, duke informuar palën kontraktuese përkatëse mbi zhvillimet më të fundit të bashkëpunimit të CEEPUS-it;

h) të kryejë një vlerësim kombëtar mbi bashkëpunimin, në rastet e zbatueshme, dhe të kontribuojë në një vlerësim të përgjithshëm të bashkëpunimit;

i) të marrë masat dhe veprimet e nevojshme së bashku me Zyrën Qendrore të CEEPUS-it, me qëllim pajtueshmërinë e plotë me Rregulloren e Mbrojtjes së të Dhënave Evropiane.

5. Tarifat për çdo kategori përcaktohen në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

a) Bazuar në pikën 6 të nenit 2, të ligjit 19/2024, muajt e pakonsumuar të bursës së studimit brenda rrjetit të CEEPUS-it, mund t'u jepen, gjithashtu, studentëve të regjistruar në një universitet të pranueshëm jashtë rrjetit të CEEPUS IV dhe anëtarëve të fakultetit ose personelit universitar të universiteteve të pranueshëm jashtë një rrjeti CEEPUS IV ("Lëvizësit e lirë"), të përcaktuar në programin përkatës të punës së CEEPUS-it dhe me kusht që të ekzistojnë masa të veçanta për studim, mësimdhënie, mbikëqyrje ose të mësuarit me bashkëmoshatarët në atë universitet. Miratimi i bursave "Lëvizësit e lirë" bëhet mbi të njëjtat kritere si për bursat e zakonshme CEEPUS, sipas pikës 4 të këtij udhëzimi.

b) Fondet e miratuara për një vit akademik, të pashpenzuara apo të kursyera në fund të vitit financiar/akademik, bazuar në ligjin 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", transferohen për vitin e ardhshëm financiar/akademik për të njëjtin qëllim.

6. Udhëzimi nr. 4, datë 16.2.2018, i MAS-it, "Për zbatimin e programit të shkëmbimit të studimeve universitare në Evropën Qendrore CEEPUS III në Republikën e Shqipërisë", shfuqizohet. Dispozitat e këtij udhëzimi zbatohen sipas kohëzgjatjes së programit CEEPUS IV, të miratuar me ligjin nr. 19/2024.

7. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Integrimit Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MAS, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ana Kapaj

SHTOJCA NR. 1

Kategoria	**Bursa/paga mujore**	**Të tjera**
Studentë të cilët janë duke ndjekur studimet e ciklit të parë, të dytë ose të tretë në institucione të arsimit të lartë në një prej shteteve pjesë të CEEPUS-it.	Paga minimale ~40,000 lekë/muaj ~400 euro/muaj	Bursa për studentët parashikon ushqimin dhe sigurimin shëndetësor bazë. Për shpenzimet e fjetjes studentëve u ofrohet maksimumi 5.000 (pesë mijë) lekë në muaj, në rastet kur ata nuk akomodohen në mjediset e shoqërisë së trajtimit të studentëve sh.a., sipas tarifave të vendosura nga Këshilli Mbikëqyrës i Ndërmarrjes së Trajtimit Studentor. Hyrje e lirë në laboratorë, biblioteka, kompjuterë, e cila u ofrohet nga institucioni i arsimit të lartë pritës. **Ndryshimet në vendimin nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, reflektohen në masën mujore të bursës për studentët.**
Profesor (zotëron gradën shkencore Doktor/Phd dhe ka eksperiencë si personel akademik me kohë të plotë mbi 10 vjet)	~ 180,960 lekë/muaj; ~ 1,810 euro/muaj;	Shpenzimet e udhëtimit, qëndrimi, fjetja dhe sigurimi shëndetësor bazë përfshihet në pagën e parashikuar; hyrje e lirë në laboratorë, biblioteka, kompjuterë, e cila u ofrohet nga institucioni i arsimit të lartë pritës. Ndryshimet në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë", të ndryshuar, reflektohen në masën e pagës mujore të personelit akademik.
Profesor i asociuar (zotëron gradën shkencore Doktor/Phd dhe ka eksperiencë si personel akademik me kohë të plotë nga	~ 157,300 lekë/muaj; ~ 1,573 euro/muaj;	Qëndrimi, fjetja dhe sigurimi shëndetësor bazë përfshihet në pagën e parashikuar; hyrje e lirë në laboratorë, biblioteka, kompjuterë, e cila u ofrohet nga institucioni i arsimit të lartë pritës. Ndryshimet në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të

5-10 vjet)		arsimit të lartë", të ndryshuar, reflektohen në masën e pagës mujore të personelit akademik.
Lektor (zotëron gradën shkencore Doktor/Phd dhe ka eksperiencë si personel akademik me kohë të plotë nga 1–5 vjet)	~ 135,005 lekë/muaj; ~ 1,350 euro/muaj;	Shpenzimet e udhëtimit, qëndrimi, fjetja dhe sigurimi shëndetësor bazë përfshihet në pagën e parashikuar; hyrje e lirë në laboratorë, biblioteka, kompjutera, e cila u ofrohet nga institucioni i arsimit të lartë pritës. Ndryshimet në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë", të ndryshuar, reflektohen në masën e pagës mujore të personelit akademik.
Asistent-lektor (zotëron diplomë "Master i shkencave" ose ekuivalent dhe ka eksperiencë si personel akademik me kohë të pjesshme/të plotë mbi 1 vit)	~ 109,720 lekë/muaj; ~ 1,097 euro/muaj;	Shpenzimet e udhëtimit, qëndrimi, fjetja dhe sigurimi shëndetësor bazë përfshihet në pagën e parashikuar; hyrje e lirë në laboratorë, biblioteka, kompjuterë, e cila u ofrohet nga institucioni i arsimit të lartë pritës. Ndryshimet në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë", të ndryshuar, reflektohen në masën e pagës mujore të personelit akademik.